

ÇËSH TJET STRATEGJIKE PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE EKONOMIKE TË FËMIJËVE DHE TË PRINDËRVE NË RASTET ME OBJEKT ZGJIDHJE MARTESE

Qendra për Nisma Ligjore Qytetare është duke zbatuar projektin me titull “*Çështjet strategjike për mbrojtjen e të drejtave ekonomike të fëmijëve dhe të prindërve në rastet me objekt zgjidhje martese*”, mbështetur nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim, PNUD, i cili synon fuqizimin e grave nëpërmjet litigimit, monitorimit, advokimit dhe medias.

Qëllimi kryesor i projektit është fuqizimi i të drejtave ekonomike të fëmijëve dhe të prindërve përgjegjës për rritjen dhe edukimin e tyre, në bazë të vendimeve gjyqësore, në çështjet me objekt “*zgjidhje martese dhe caktimi i detyrimit ushqimor për fëmijët*”.

Objektivat specifike të projektit janë:

1. Të rritet aksesimi i grave në sistemin e drejtësisë për caktimin e detyrimit ushqimor dhe ndryshimin e masës së pensionit ushqimor.
2. Të përmirësohet sistemi i zbatimit më të mirë të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, për masën e pensionit ushqimor.
3. Të nxitet debati publik për garantimin e të drejtave ekonomike të grave dhe fëmijëve, në rastet e divorceve apo ndarjeve bashkëshortore.
4. Të informohen gratë për të drejtat ligjore dhe institucionet në mbështetje të tyre.

Në kuadër të këtij projekti, u ngrit një skuadër e re *pro bono*, me studentë të Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, të cilët u trajnuan nga ekspertët e projektit për të kryer monitorimet e vendimeve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, si dhe zbatimin e tyre nga Zyra e Përmbarimit. Ky monitorim është mbështetur në një skedë monitoruese të përgatitur nga ekspertët e projektit, të cilët kanë mbikëqyrur monitorimet e kryera nga studentët.

Gjatë periudhës Maj – Korrik 2015 u monitoruan 655 vendime të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, me objekt zgjidhje martese, 33 vendime me objekt caktim i detyrimit ushqimor, si dhe 37 vendime me objekt ndryshimi i masës së detyrimit ushqimor për fëmijët.

Disa nga problemet që u konstatuan gjatë monitorimit, janë masa e pamjaftueshme e detyrimit ushqimor të caktuar nga gjykata për fëmijët, krijohet një raport gjinor midis masës së detyrimit ushqimor me prindërit, pasi në përqindjen më të lartë të rasteve, nënat e divorcuara caktohen nga gjykata për rritjen dhe edukimin e fëmijëve. Nga analiza e faktorëve, në të cilët mbështetet gjykata në caktimin e masës së detyrimit ushqimor, rezulton se çështjet gjinore për fuqizimin ekonomik, duhet të njihen më mirë nga gjyqtarët; nga njohja e situatës së ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, rezulton një numër i konsiderueshëm vendimesh gjyqësore, të pa ekzekutuara etj.

Rezultatet dhe rekomandimet që kanë dalë nga monitorimi i vendimeve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si dhe akteve të zbatimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, nga Zyra e Përmbarimit Tiranë, do të ndahen me të gjitha institucionet përgjegjëse, do të bëhen publike në median e shkruar dhe elektronike, si dhe në website-in e Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare www.qag-al.org